

**Në përgjigje të e-mailit, “Kërkesë për informacion”, datë 22.10.2024, informojmë sa më poshtë vijon:**

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në zbatim dhe përputhje me Ligjin Nr. 10 383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në zbatim të këtij Ligji, personat e siguruar ose kategori të tjera të përcaktuara në Ligj, përfitojnë trajtimin me barna të Listës së Barnave të Rimbursuara, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, **Nr. 491, datë 24.7.2024** “Për miratimin e Listës së Barnave që Rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”, duke respektuar kufizimet e saj dhe protokollat e përdorimit të barnave. **Hartimi i Listës së Barnave të Rimbursueshme 2024, është mbështetur në parimin e mbulimit të alternativës më të lirë<sup>1</sup>.**

Si pjesë e saj, “Kalistra 40/5mg” rezulton në pozicione të ndryshme, edhe brenda vitit 2024, për arsyet sa më poshtë:

Lista aktuale e Barnave të Rimbursuara, ajo në fuqi, e miratuar me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 491, datë 24.7.2024 “Për miratimin e Listës së Barnave që Rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”, e cila **i filloi efektet e saj në 1 Gusht 2024, është një listë e re barnash.**

Kjo do të thotë, që në të janë reflektuar çmimet e reja CIF & EXW për vitin 2024, të cilat janë deklaruar pranë MSHMS dhe miratuar nga Komisioni i Çmimit të Barnave, si dhe bazuar në legjislacioni në fuqi dhe kriteret e hartimit të LBR-së, janë përfshirë barnat alternativa tregëtare, formë doza të principeve aktive të LBR, ashtu sikurse janë hequr ato barna alternativa tregëtare, të cilat nuk kanë pasur çmime të deklaruar për vitin 2024.

Referuar barit të LBR 2024 me emër tregëtar “Kalistra 40/5mg”, me Princip Aktiv “Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg”, e Kompanisë Mbajtëse të Autorizimit për Tregëtim MENARINI INTERNATIONAL OPERATIONS, e rradhitur si alternativë e tretë tregëtare në LBR në fuqi; pasqyrohet si më poshtë:

---

<sup>1</sup> Referuar Nenit 10, Pika 2, shkronja b, të Ligjit Nr. 10.383 datë 24.02.2011, “Struktura e listës së barnave përcaktohet në bazë të listës së barnave themelore, sipas klasifikimit INN (principit aktiv të barit), të përcaktuar nga OBSH, si dhe në mbulimin e alternativës më të lirë”.

Kod Bari	Kodi ATC	Principi Aktiv dhe Doza	Forma	Emri Tregëtar	Mbajtësi i Autorizimit për Tregëtim	Çmimi Referencë	Çmimi i Pacientit	Rimbursimi
652/237	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Olmesartan + Amlodipine / Sandoz	SANDOZ	25.73	12.87	12.86
652/73	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Olssa	KRKA	25.73	12.87	12.86
652/464	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Ameya Combo	ALIUD PHARMA GMBH	50.27	37.41	12.86
652/398	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Kalistra 40/5mg	MENARINI INTERNATIONAL OPERATIONS	62.79	49.93	12.86
652/463	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Sevikar	DAIICHI SANKYO EUROPE GMBH	78.51	65.65	12.86

Në të dyja LBR-të e miratuara para LBR –së në fuqi, të cilat e kanë pasur efektin gjatë vitit 2024, janë reflektuar vetëm çmimet e barnave, por nuk ka rezultuar ndryshim pozicionesh, pasi çmimi i aplikuar për barin “Kalistra 40/5mg” ka qënë më i ulët se ai i barit tjetër.

Konkretisht, në LBR të miratuar me VKM Nr. 196, datë 5.04.2023 “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 489, datë 30.07.2021, të KM, “Për miratimin e Listes së Barnave që Rimbursohen nga FSDKSH dhe masës së mbulimit të çmimit të tyre”, të ndryshuar; e cila e ka shtrirë efektin nga 1 Maji 2023, deri në 7 Prill 2024; bari pasqyrohet:

Kod Bari	Kodi ATC	Principi Aktiv dhe Doza	Forma	Emri Tregëtar	Mbajtësi i Autorizimit për Tregëtim	Çmimi Referencë	Çmimi i Pacientit	Rimbursimi
652/398	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Kalistra 40/5mg	MENARINI INTERNATIONAL OPERATIONS	71.7	35.85	35.85
652/463	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Sevikar	DAIICHI SANKYO EUROPE GMBH	89.64	53.79	35.85

Ndërsa në LBR të miratuar me VKM Nr. 209, date 3.04.2024 “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 489, datë 30.07.2021, të KM, “Për miratimin e Listes së Barnave që Rimbursohen nga FSDKSH dhe masës së mbulimit të çmimit të tyre”, të ndryshuar, e cila e ka shtrirë efektin nga 8 Prill 2024 deri në 31 Korrik 2024; bari pasqyrohet:

Kod Bari	Kodi ATC	Principi Aktiv dhe Doza	Forma	Emri Tregëtar	Mbajtësi i Autorizimit për Tregëtim	Çmimi Referencë	Çmimi i Pacientit	Rimbursimi
652/398	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Kalistra 40/5mg	MENARINI INTERNATIONAL OPERATIONS	64.20	32.10	32.10
652/463	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg	f.c.tabl.	Sevikar	DAIICHI SANKYO EUROPE GMBH	80.28	48.18	32.10

Bari “Kalistra 40/5mg” rezulton alternativë e parë, nga dy alternativa në total të Principit Aktiv “Olmesartan + Amlodipine 40 + 5 mg”.

**Lista e Barnave të Rimbursueshme ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit, për të gjithë pacientët dhe në veçanti, për shtresat në nevojë.**